



Pranimi / Dorezimi Priljege/Priloge Received/ Delivered	21.02.2022	2	viti god year
Organ / Shpresa Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shprehje e Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	901/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.81/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1451/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.201/2020 të datës 22.07.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

Komuna Prishtinë, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.201/2020 e datës 22.07.2020 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 22.07.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Administrata Tatimore e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 të Marrëveshje së Përgjithshme Kolektive lidhur me mos pagesën e shpërblimit jubilar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 30.07.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 07.08.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 1492/2020 së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 1599/2020 të datës 21.08.2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës A.nr.201/2020 të datës 22.07.2020, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 24.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1451/20. me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2020 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit A.nr. 201/2020 të datës 22.07.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1406/2020 të regjistruar me numër A.nr.201/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 22.07.2020; Njoftimin e Menaxheres së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës të datës 16.07.2020 me numër prot:11/24; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës e datës 14.07.2020 me numër prot:11-06/2232; Kontratën e punë së ankuesit e datës 23.02.2010 me numër prot:02/853/09; Listën e pagës së ankuesit për periudhën prej 01.06.2020 deri më datë 30.06.2020 me kod:10-11600-201-0112; E-mailin e datës 22.07.2020 dërguar nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.07.2020 me numër prot:1440/2020; E-mailin e datës 07.08.2020 dërguar nga V.S më përgjigjen në kërkesë i protokolluar me numër:1492/2020 me shkresa 1/10; Përgjigjen e datës 07.08.2020 dërguar nga Menaxherja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës për Këshillin me numër protokollit:269; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit i datës 28.12.2018 me numër prot:02/853/09; Akt emërimit të ankuesit të datës 28.08.2013 me numër prot:02/853/09; Njoftimin e datës 21.08.2020 me numër protokollit:1599/2020; Aktgjykimin A.nr.1451/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 24.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, respektivisht sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 28.12.2018, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, në pozitën e punës "Zyrtar i lartë ligjor".

Ankuesi i pa kënaqur me kompensimin në vlerë prej tetëdhjetë (80) euro i realizuar me datë 30.06.2020 për shpërblimin e përvjetorit (jubile) të shërbimit në Shërbimin Civil, me datë 14.07.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me pretendimin ankimor se ankuesit i takon edhe kompensimi i një (1) page në vlerën e pagës së muajit të fundit sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 09.07.2020 meqenëse i njëjti nuk ka paraparë që brenda institucionit të ketë Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ankuesi me sygjërim të Njesisë së Burimeve

Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.07.2022 në pajtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se në bazë të listës së pagës së ankuesit të periudhës prej 01.06.2020 deri më datë 30.06.2020 me kod:10-11600-201-0112, ankuesi është kompensuar në vlerë prej nëntëdhjetë euro e shtatëdhjetë cent (93.70 euro), dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Administratat Tatimore e Kosovës ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)”* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *“Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”*.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se i takon kompensimi edhe i një (1) page në vlerën e pagës së muajit të fundit për shpërblimin e përvjetorit (jubile), sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, andaj mbi këtë bazë, pretendimi ankimor është i pabazuar ngase për të punësuarit në shërbimin civil e vetnija formë për kompensimin e shpërblimit të përvjetorit (jubile) është ajo e përcaktuar me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.




KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.81/2022

Flakron GASHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratës Tatimore të Kosovës;
- Z.Ramush Bardiqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

